


YouthInfoComp

SUAZA E KOMPETENCAVE TË
PUNONJËSVE TË INFORMACIONIT
TË RINISË



European youth information
and counselling agency

eurodesk





european youth information
and counselling agency

eurodesk

Autorët: Audrey Frith, Eva Reina, Imre Simon, Safi Sabuni.

Kontribuesit: Claire Conlon, Franck Chabriac, Giovanni Maccioni, Joaquim Freitas, Kadri Koort, Luis O. Reyes Torregrosa, Regina Pfeifer, Sarah Spiteri, Susan Scott.

Korrektura letrare: Jessica Walker

Paraqitja dhe dizajni: Javier Larios (javierlarios@me.com)

Kemi bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të gjurmuar referencat e teksteve dhe veprimtaritë në to derisa të mbërrinim tek autorët e tyre, me qëllim që t'u jepnim meritat e duhura. Kërkojmë ndjesë për çdo lënie të mundshme pa përmendje dhe me kënaqësi do të bëjmë korrigjimet e nevojshme në botimin e ardhshëm.

Botuar nga ERYICA dhe Eurodesk, Shtator 2021.

Për shkak të preokupimit tonë për mjedisin, ky botim shpërndahet kryesisht në format elektronik. Ne botuam një numër minimal kopjesh të printuara, duke përdorur me përgjegjësi materialet e letrës së thjeshtë/të ricikluar, bojës pa alkool dhe një kompani printimi të ndërgjegjshme për çështjet mjedisore.

Ky botim është i licencuar nën një Licencë Ndërkombëtare Creative Commons Attribution-NonCommercial- NoDerivatives 4.0



Pasqyra e Lëndës

Hyrje	4
Introduction	6
Background	8
Project Partners	9
Pjesa 1	
Puna informative	
Rinore në Evropë	10
1.1 Çfarë është puna informative për të rinjtë?	11
1.2 Kush janë Punonjësit e Informacionit Rinor?	12
1.3 Tema	13
1.4 Operimi	13
Pjesa 2	
Kuadri i kompetencave	
Të punonjësve të informacionit rinor	16
2.1 Tablo e përgjithshme	17
2.2 Përkufizim	18
2.3 Kompetenca	19
2.4 Rezultatet e të mësuarit	21
2.5 Përdorimi i kuadrit të kompetencave	23
Shtojca 1 Mësimi	
Rezultatet	24

Parathënia



Shërbimet e informacionit dhe këshillimit për të rinjtë, luajnë një rol vendimtar në kalimin e të rinjve drejt moshës madhore. Ndërkohë që ky si profesion është i mire-organizuar dhe ka lënë pas vetes një histori të respektueshme, përcaktimi se kush është punonjësi i informacionit për të rinjtë, ose se çfarë kompetencash duhet të zotërojë, nuk është aspak e përcaktuar në mënyrë unanime. Kjo është arsyeja përse autorët kanë vendosur të krijojnë këtë kornizë kompetencash. Pavarësisht nga specifikat kombëtare, ata i kuptojnë njëlloj vlerat thelbësore që mbështesin profesionin në fjalë, si dhe shembuj të praktikave të mira kombëtare. Kuadri i kompetencës i detajuar në këtë botim, është i pari në nivel evropian dhe synon të jetë një referencë e fortë për të gjitha vendet që dëshirojnë ta vlerësojnë këtë profesion. Përkufizimi i punonjësit të informacionit për të rinjtë si profesion në bazën e të dhënave evropiane të aftësive, kompetencave, kualifikimeve dhe profesioneve (ESCO), i parapriu atij kuadri me vetëm disa muaj.

Çfarë është atëherë puna informative për të rinjtë? Shpërndarja e informacionit për të rinjtë është një funksion qendror i punës me të rinjtë dhe ka vlerat kryesore të saj: ajo synon të jetë e hapur për të gjithë të rinjtë dhe të veprojë në interesin e tyre duke mbuluar çështje që kanë rëndësi për ta, si dhe duke ofruar një spektër të gjerë veprimtarish (informimi, këshillimi psikologjik, këshillimi i thjeshtë, mbështetja, trajnimi dhe përgatitja, rrjetëzimi dhe referimi në shërbime të specializuara). Këto veprimtari mund të ofrohen nga qendrat e informacionit për rininë, përmes shërbimeve të informacionit për të rinjtë, punonjësve të informacionit për të rinjtë dhe strukturave të tjera, përmes bashkëmoshatarëve, duke përdorur takime ballë për ballë dhe/ose përmes mjediseve dixhitale me zhvillimin e shërbimeve dixhitale.

¹ Angazhoni. Informoni. Fuqizoni. Dokument pozicionimi. Rekomandime nga rrjetet kryesore Evropiane të Informacionit dhe Lëvizshmërisë Rinore mbi Strategjinë e re të BE-së për Rininë. EYCA, ERYICA, Eurodesk (2017).

Ky publikim ka ardhur në një kohë kur Evropa dhe bota po i përgjigjen ndikimit të pandemisë COVID-19; kriza përkeqësoi çështjet politike, ekonomike dhe sociale dhe theksoi rëndësinë e mirëqenies personale, ripërtëritjes dhe aftësisë tonë për t'u përshtatur me ndryshimet. Për më tepër, pasojat e pandemisë goditën në mënyrë disproporcionale të rinjtë. Papunësia tek të rinjtë ka arritur sërish rekord, dhe pothuajse tre në katër të rinj kanë ndjerë nevojën për të kërkuar ndihmë në lidhje me mirëqenien e tyre fizike dhe mendore. Për më tepër, për të rinjtë, pandemia ndodhi gjatë një kohe vendimtare, formuese dhe mund të ketë shkaktuar probleme në rritje në veçanti për të rinjtë e pafavorizuar ose të pambrojtur. Të rinjtë do të jenë kyç për rimëkëmbjen e shoqërisë dhe roli i punonjësve të informacionit për të rinjtë do të jetë thelbësor në mbështetjen e të rinjve për të shfrytëzuar potencialin e tyre krijues, qytetar dhe social. Suaza e kompetencave për punonjësit e informacionit për të rinjtë, synon të sigurojë që profesionistët e informacionit për të rinjtë të kenë kompetencat e nevojshme për të mbështetur të rinjtë dhe për të ofruar shërbime cilësore në këtë përpjekje dhe më gjerë. Kjo do të çojë në rritjen e cilësisë, në një mirëkuptim dhe dukshmëri më të madhe midis përdoruesve, politikë bërësve dhe palëve të interesuara, dhe krijimin e një komuniteti aktorësh në nivel evropian.

Dy rrjete evropiane të informacionit dhe lëvizshmërisë për të rinjtë, Agjencia Evropiane e Informacionit dhe Këshillimit për Rininë (ERYICA) dhe Eurodesk, u bashkuan për të përforcuar punën e informacionit për të rinjtë duke hartuar këtë kornizë kompetencash. Ata shfrytëzuan profesionalizmin dhe përvojën e përfaqësuar në rrjetet e tyre mbarë evropiane dhe profesionistët e punës me të rinjtë që u mbledhën në një grup pune. Përveç kësaj, korniza që erdhi si frut i punës së tyre, bazohet në shembuj ekzistues nga vende të ndryshme, dy sondazhe evropiane dhe konsultimet më të gjera të mundshme. Autorët shpresojnë se ajo do të kontribuojë në njohjen e mëtejshme të informacionit dhe këshillimit të të rinjve - prandaj nuk shënon fundin, por fillimin e këtij rrugëtimi.



2 Ndikimi i COVID-19 në shëndetin mendor të adoleshentëve dhe të të rinjve. UNICEF (2020).

3 Rezoluta e Parlamentit Evropian për ndikimin e COVID-19 tek të rinjtë dhe sporti (2020/2864(RSP)).

Prezantim

Të rinjtë sot përballen me një sërë sfidash dhe mundësish komplekse ndërkohë që ndërtojnë identitetin e tyre, bëjnë zgjedhje dhe angazhohen me familjen, bashkëmoshatarët dhe shoqërinë. Në të gjithë Evropën, puna e informacionit për të rinjtë (në tekstin e mëtejme «PIR») synon të garantojë të drejtën e të rinjve për informacion të plotë dhe të besueshëm për t'i ndihmuar ata të marrin vendime. Punonjësit e informacionit për të rinjtë, ose çdo profesionist i punës rinore që jep informacion për të rinjtë, (në tekstin e mëtejme «punonjësit e IR») punojnë në një sërë mjedisesh dhe organizatash dhe përpiqen të angazhojnë dhe fuqizojnë të rinjtë në një mënyrë që pasqyron realitetet dhe kompleksitetet me të cilat përballen.

Për të mbështetur këtë punë, Eurodesk dhe ERYICA kanë bashkëpunuar me punonjësit e IR dhe palët e interesuara nga sektori i të rinjve në mbarë BE-në për të zhvilluar **YouthInfoComp: Korniza e Kompetencës së Punonjësve të Informacionit Rinor**.

Korniza ofron një mjet referimi të përbashkët për përshkrimin e kompetencave (njohurive, aftësive dhe qëndrimeve) të kërkuara nga punonjësit e IR, ose çdo profesionist i punës së të rinjve që jep informacion për të rinjtë.

Një kornizë kompetencash mund të veprojë si një mënyrë e përbashkët për të identifikuar, përshkruar dhe zhvilluar kompetencat e punonjësve të informacionit të të rinjve. Korniza është krijuar për të vepruar si një **mjet komunikimi për të shpjeguar misionin vendimtar** të punonjësve të informacionit për të rinjtë dhe si **referencë dhe udhëzues praktik** për funksionimin, cilësinë dhe njohjen e vlerës së punës informative rinore në Evropë.

Kuadri në fjalë, kërkon të përforcojë natyrën dhe identitetin e PIR-ëve dhe të mbështesë njohjen e vlerave dhe qëllimet e tij. Kornizat e kompetencave mund të frymëzojnë dhe të jenë një pikënisje për planifikimin strategjik, përmirësimin e cilësisë, zhvillimin e aftësive dhe komunikimin.


Punonjësit e IR-së janë në qendër të kornizës së kompetencave. Kuadri mbështet të kuptuarit dhe zhvillimin e kompetencave të kërkuara nga punonjësit e informacionit për të rinjtë, për të mbështetur të rinjtë në mënyrë profesionale. Korniza bazohet në një përkufizim të përbashkët të profilit të punonjësve të informacionit për të rinjtë dhe përshkruan se si punonjësit mund të mbështesin të rinjtë, të ofrojnë një shërbim cilësor dhe të rrisin ndikimin dhe shtrirjen e shërbimeve të informacionit për të rinjtë.

YouthInfoComp është një kornizë referimi; Ajo nuk synohet të merret si një përshkrim urdhërues i një standardi profesional që duhet të zbatohet në një mënyrë specifike. Megjithatë, korniza përshkruan grupin minimal të kompetencave që kërkohen për punonjësit e informacionit të rinjve për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë profesionale.

Suaza mund të përshtatet dhe zbatohet në kontekste të ndryshme kombëtare, rajonale dhe vendore. Ajo mund të mbështesë zhvillimin e kompetencave të punonjësve individualë të IR-së, të mbështesë moralin e ekipeve dhe organizatave që ofrojnë informacion për të rinjtë dhe mund të përdoret për të realizuar njohjen ligjore dhe profesionale të punës së informacionit për të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal ose vendor.

YouthInfoComp është rezultat i bashkëpunimit dhe konsultimit nga palët e interesuara në të gjithë Evropën dhe thekson arritjet dhe natyrën tejkombëtare të punës së informacionit për të rinjtë në nivel evropian. Ky kuadër është i harmonizuar me dokumentet kryesore të politikave si p.sh Parimet e Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë [Principles of the European Youth Information Charter](#) dhe Eurodesk, 10 Parimet Kyçe [Eurodesk 10 Key Principles](#) dhe mund të përdoret si një shtesë e kornizave tashmë të krijuara të informacionit për të rinjtë.

Pjesa 1 e këtij botimi përshkruan sfondin e këtij projekti dhe natyrën e punës së informacionit për të rinjtë në Evropë. **Pjesa 2** përcakton strukturën dhe përmbajtjen e *YouthInfoComp*.



Sfondi

Puna që çon në zhvillimin e YouthInfoComp filloi në vitin 2019 kur Eurodesk u ftua nga Drejtoria e Përgjithshme për Punësimin, Çështjet Sociale dhe Përfshirjen (DGEMPL) e Komisionit Evropian për t'iu bashkuar Komunitetin FORA të ESCO.

ESCO (Aftësitë, Kompetencat, Kualifikimet dhe Profesionet Evropiane) është klasifikimi shumëgjuhësh evropian i aftësive, kompetencave, kualifikimeve dhe profesioneve. ESCO funksionon si një fjalor ose taksonomi, duke përshkruar, identifikuar dhe klasifikuar profesionet dhe aftësitë profesionale të rëndësishme për tregun e punës dhe arsimin dhe trajnimin e BE-së.

Qëllimi i ESCO është të mbështesë lëvizshmërinë e punës në të gjithë Evropën dhe për rrjedhojë një treg më të integruar dhe efikas të punës, duke ofruar një «gjuhë të përbashkët» për profesionet dhe aftësitë që mund të përdoren nga aktorë të ndryshëm për punësimin, arsimin dhe trajnimin.

ESCO ofron përshkrimet të 2,942 profesioneve dhe 13,485 aftësive të lidhura me to, të përkthyer në 27 gjuhë (të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së, si dhe islandisht, norvegjisht dhe arabisht). Megjithatë, në atë kohë, ESCO nuk përfshinte një përshkrim të profesionit të punonjësit të informacionit të rinjve ose aftësive të lidhura me të.

Në shtator 2019, Eurodesku, ERYICA, Partneriteti Rinor i KE-CoE dhe Qendra Burimore e Trajnimit Salto, formuan një partneritet për të përpiluar një aplikim në ESCO. Grupi zhvilloi një anketë midis palëve të interesuara të punonjësve të informacionit për të rinjtë midis nëntorit dhe dhjetorit 2019, anketim i cili mblodhi **103 përgjigje nga 25 vende**. Rezultatet nga sondazhi iu dërguan ESCO-s dhe të dhëna të mëtejshme (një përkufizim, përkthime, terma të përditësuar të aftësive) u dërguan gjithashtu në gusht 2020. Që nga nëntori 2020, profesioni i Punonjësit të Informacionit Rinor (punonjësi i IR) është përfshirë në ESCO dhe qe rishikuar nga Shtetet Anëtare në janar 2021. Një version i ri i ESCO do të botohet deri në fund të 2021.

Mbi këtë bazë, Eurodesk dhe ERYICA zhvilluan një kornizë kompetencash për të mbështetur zhvillimin dhe kuptimin e profesionit të PIR dhe vlerave të tij thelbësore. Më pas u publikua një thirrje për të krijuar një grup pune për të udhëhequr procesin e zhvillimit. Grupi i punës u takua në nëntor 2020, janar 2021 dhe mars 2021 dhe mbikëqyri zhvillimin konceptual, hartimin dhe konsultimin për kornizën dhe publikimin.

Partnerët e projektit

eurodesk

Eurodesk është një rrjet evropian i informacionit për të rinjtë i krijuar në vitin 1990. Si një organizatë mbështetëse për Erasmus+ dhe Strategjinë e BE-së për Rininë, Eurodesk e bën gjithëpërfshirës dhe të qasshëm informacionin mbi lëvizshmërinë e të mësuarit për të rinjtë dhe ata që punojnë me ta.

Me një rrjet prej 38 qendrash Eurodesk të lidhura me mbi 1600 ofrues vendorë informacioni në 36 vende evropiane, Eurodesk rrit ndërgjegjësimin për mundësitë evropiane dhe inkurajon të rinjtë të bëhen qytetarë aktivë.

Eurodesk-u federon mbi 1,600 ofrues vendorë të informacionit për të rinjtë, të ashtuquajturit «shumëfishues dhe ambasadorë» që janë organizata rajonale ose vendore të cilat punojnë me të rinjtë, duke ofruar informacione për të rinjtë dhe duke këshilluar të rinjtë për mundësitë e lëvizshmërisë.

Për të siguruar cilësinë e shërbimeve në të 36 vendet, Eurodesk-u u ofron anëtarëve të tij trajnim dhe mbështetje cilësore, si dhe akses në shërbimet dhe mjetet e informacionit për të rinjtë. Eurodesk-u drejton shërbime dixhitale për të rinjtë si Opportunity Finder, e cila është një bazë të dhënash me mbi 250 programe. Ai gjithashtu bashkë-menaxhon Portalin Evropian të Rinisë me Komisionin Evropian.



european youth information
and counselling agency

Agjencia Evropiane e Informacionit dhe Këshillimit për Rininë (ERYICA) është një organizatë e pavarur evropiane, e përbërë nga 38 organe dhe rrjete kombëtare dhe rajonale për koordinimin e informacionit për të rinjtë në 26 vende. Ajo ka punuar që nga viti 1986 për intensifikimin e bashkëpunimit evropian dhe ndërkombëtar në fushën e punës dhe shërbimeve informative për të rinjtë. Ajo zhvillon, mbështet dhe promovon politikën dhe praktikën cilësore të informacionit të përgjithshëm për të rinjtë në të gjitha nivelet, me qëllim që të plotësojë nevojat për informacion të të rinjve dhe që të zbatojë parimet e Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë.

ERYICA synon të mbrojë të drejtën e të rinjve për informacion të plotë dhe të besueshëm, i cili i ndihmon ata të bëjnë zgjedhjet me të cilat përballen në jetën e tyre dhe që promovon autonominë e tyre, aftësinë për të menduar në mënyrë kritike dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri.

ERYICA gjithashtu avokon në nivel kombëtar dhe evropian për përfshirjen e informacionit dhe këshillimit për të rinjtë në politikat rinore dhe në fusha të tjera të politikave kryesore që prekin të rinjtë. Që nga krijimi i saj, Agjencia ka bashkëpunuar gjerësisht me Këshillin e Evropës, Komisionin Evropian dhe së fundmi me UNESKON.

PJESA 1

Puna Informative Rinore në Evropë



1.1 Çfarë është puna informative për të rinjtë?

Informacioni për të rinjtë, është informacion cilësor pa pagesë, që i fuqizon të rinjtë të ushtrjnë të drejtat e tyre, të marrin vendime të përgjegjshme dhe të marrin pjesë në shoqëri. Shërbimet e informacionit për të rinjtë synojnë të mbështesin dhe fuqizojnë të rinjtë me informacion të plotë dhe të besueshëm mbi të drejtat dhe opsionet e tyre për të adresuar nevojat, interesat dhe mirëqenien e tyre.

Punonjësit e informacionit për të rinjtë u ofrojnë të rinjve informacion të **besueshëm, të saktë dhe të kuptueshëm**. Ato sigurojnë që shërbimet e informacionit të jenë të aksesueshme, të pasura në burime dhe mikpritëse, të kuptojnë dhe adresojnë nevojat e të rinjve dhe t'i udhëzojnë të rinjtë të veprojnë në mënyrë autonome, si dhe që të mendojnë në mënyrë kritike. Këto shërbime kanë edhe një funksion të spikatur parandalues që përbën një përfitim të madh për shoqërinë.

Veprimtaritë e informimit për të rinjtë në të gjithë BE-në, përfshijnë një gamë të gjerë shërbimesh dhe veprimtarishë, të tilla si informimi, këshillimi, mbështetja, stërvitja, trajnimi, të mësuarit nga bashkëmoshatarët, rrjetëzimi ose referimi në shërbime të specializuara. Shërbimet mund të vendosen në korniza të ndryshme dhe të ofrohen nga aktorë shumë të ndryshëm, në mjedise të ndryshme dhe të kryhen përmes veprimtarive të komunikimit në internet dhe/ose ballë për ballë duke shënjestruar përdoruesit individualisht ose në grup.

PIR mbulon një sërë temash që pasqyrojnë gjerësinë dhe diversitetin e përvojave dhe nevojave të të rinjve. Punonjësit duhet të **kujdesen për nevojat në ndryshim të informacionit të të rinjve**, të gjejnë mënyra novatore për t'iu përgjigjur problemeve të reja sociale, të zbulojnë shkaqet shoqërore të problemeve me të cilat përballen të rinjtë, të ofrojnë një gamë të plotë informacioni për të rinjtë që hyjnë në një shoqëri komplekse dhe t'i ndihmojnë ata të përballen me mbingarkesën e informacionit. Kjo mund të përfshijë referimin e të rinjve në shërbime ose burime të tjera të përshtatshme për t'u marrë me çështje komplekse, duke përfshirë kur është e nevojshme këshilla ose veprime ligjore ose të tjera profesionale⁴.



⁴ Ky përshkrim është përshtatur nga Përmbledhja e strukturave kombëtare të informacionit dhe këshillimit për të rinjtë (f.42). ERICA dhe Këshilli i Evropës (2015)

1.2 Kush janë Punonjësit e Informacionit Rinor?

YouthInfoComp është ndërtuar mbi përkufizimin e mëposhtëm të rolit të punonjësve të IR-së:

Punonjësit e informacionit për të rinjtë, ose profesionistë të tjerë që ofrojnë informacion për të rinjtë, ofrojnë shërbime të informacionit për të rinjtë në një sërë mjedisesh/rrethanash për të mbështetur mirëqenien e tyre. Ato sigurojnë që shërbimet e informacionit të jenë të aksesueshme, të pajisura me burime dhe mikpritëse për të rinjtë dhe të organizojnë veprimtari informuese në internet dhe/ose ballë për ballë që synojnë përdoruesit individualë dhe gruporë. Punonjësit e informacionit të të rinjve synojnë t'u mundësojnë të rinjve të bëjnë zgjedhjet e tyre të informuara dhe të bëhen qytetarë autonomë dhe aktivë.



YouthInfoComp është projektuar për të pasqyruar çdo aspekt të përkufizimit: përfituesit, qëllimi dhe synimet, cilësimet, karakteri i shërbimeve të ofruara dhe mënyra e ofrimit, secila prej këtyre plotësojnë natyrën e kornizës dhe kompetencat e përfshira.

Punonjësit e informacionit të të rinjve synojnë⁵:

- të sigurojnë informacion të besueshëm, të paanshëm, të saktë dhe miqësor ndaj të rinjve;
- të lehtësojnë aksesin në burime dhe kanale të ndryshme informacioni;
- të krijojnë një pasqyrë të opsioneve të disponueshme për tema të rëndësishme për të rinjtë;
- të ndihmojnë të rinjtë të lundrojnë në mbingarkesën e informacionit të shoqërisë moderne;
- të sigurojnë që të rinjtë të njohin të drejtat e tyre, shërbimet në dispozicion dhe mënyrën se si t'u qasen atyre;
- të mbështesin të rinjtë në vlerësimin e informacionit në dispozicion dhe cilësisë së tij;
- t'i udhëzojnë të rinjtë që të gjejnë opsionet më të mira në dispozicion dhe të marrin vendimet e tyre;
- të ofrojnë kanale të ndryshme komunikimi dhe dialogu për të mbështetur drejtpërdrejt të rinjtë në kërkimin e tyre për informacion dhe njohuri; dhe
- të kontribuojnë në edukimin mediatik dhe informativ të të rinjve.

⁵ Marrë nga *Informacioni dhe këshillimi i rinisë në Evropë në 2020 (f.9). ERYICA (dhjetor 2020). Botuar sipas Marrëveshjes së Partneritetit ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Agjencisë Evropiane të Informacionit dhe Këshillimit për Rininë (ERYICA).*

1.3 Temat

YouthInfoComp (shiko Pjesa 2) nënvizon rolin kyç të ndërtimit të njohurive në profesionin e punës së informacionit të të rinjve, si dhe **kompetencat e nevojshme për të menaxhuar, për të patur qasje, si dhe për të vlerësuar informacionin**. Lista e mëposhtme pasqyron larminë e temave për të cilat një i ri mund të ketë nevojë për informacion ose mbështetje, por më e rëndësishmja, kompetencat e punonjësit të informacionit për të rinjtë shtrihen në përshtatjen dhe përdorimin e informacionit për të paraqitur opsione për të rinjtë në përputhje me nevojat e tyre.

-
- | | |
|--|--|
| » Edukim dhe trajnim | » Këshilla ligjore |
| » Punësim | » Qasja tek të drejtat |
| » Koha e lirë | » Mbështetje në raste dhune |
| » Lëvizshmëri ndërkombëtare | » Mbështetje për të rinjtë me prejardhje të pafavorshme dhe vulnerabël |
| » Vullnetarizmi | » Mbështetje për migrantët dhe refugjatët e rinj |
| » Qytetaria dhe pjesëmarrja aktive | » Integrimi i të rinjve me aftësi të kufizuara |
| » Shëndet dhe mirëqenie | » Siguria në internet |
| » Njohuri mediatike dhe informative | » Kartë/a zbritjeje në çmim për të rinjtë |
| » Sipërmarrje | » Bujtina dhe akomodim për të rinj |
| » Barazia gjinore dhe identiteti | » Siguria rrugore |
| » Strehimi | » Menaxhimi i financave |
| » Seksualiteti dhe marrëdhëniet intime | |
| » Marrëdhëniet në familje dhe me miqtë | |
-

1.4 Operim

Puna informuese për të rinjtë kryhet në një **sërë mjedisesh dhe kontekstesh të ndryshme** dhe shërbimet e ofruara mund të plotësojnë nevojat e një grupi po aq të ndryshëm të rinjsh, me nevoja komplekse, sfida dhe vendime për të marrë. Është thelbësore që punonjësit dhe ekipet që ofrojnë informacion për të rinjtë të jenë të pajisur me kompetencat e nevojshme për të operuar shërbime efektive, profesionale, të mbështetura nga vlera që u shërbejnë nevojave të përfituesve të synuar. YouthInfoComp është zhvilluar për të pasqyruar format e ndryshme të shërbimeve të informacionit për të rinjtë dhe kështu mund të aplikohet në ngritjen, funksionimin dhe proceset e përmirësimit të shërbimeve të informacionit për të rinjtë, pavarësisht nga përcaktimi i tyre.

Politika rinore, në shumë vende evropiane, zakonisht organizohet rreth tre shtyllave kryesore⁶:

- Organizatat rinore
- Puna e hapur për të rinjtë
- Shërbimet e informacionit për rininë

⁶ Cërmbledhje e strukturave kombëtare të informacionit dhe këshillimit rinor (fq. 67-79), ERYICA dhe Këshilli i Evropës, (Maj 2015)

Organizatat rinore ndërveprojnë me të rinj aktivë, ndërsa Open Youth Work përqendrohet kryesisht tek të rinjtë vulnerabël. **Shërbimet e informacionit për të rinjtë mund të jenë më transversale në ofrimin e mbështetjes për të gjithë të rinjtë; duke i ndihmuar ata të lundrojnë në gamën komplekse të shërbimeve të informacionit për qytetarët dhe duke lehtësuar qasjen e tyre në programet dhe mundësitë përkatëse.** Shërbimet janë subjekte jo-tregtare dhe punojnë në përputhje me parimet e Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë .

Natyra e hapur, fleksibël dhe e paanshme e shërbimeve të informacionit për të rinjtë, do të thotë se ato tërheqin një grup më të larmishëm të rinjsh. Të rinjtë, si dhe palët e interesuara, mund të përfshihen drejtpërdrejt në bashkë-projektimin e shërbimeve të informacionit për të siguruar shpërndarjen në kohë të informacionit përkatës me qëllim përmbushjen e nevojave në ndryshim për informacion të të rinjve. Shërbimet e informacionit për të rinjtë ofrohen në mënyrë të pavarur nga çdo ndikim komercial, politik, fetar ose ndonjë ndikim tjetër, i cili do të ndryshonte përmbajtjen e informacionit të kërkuar nga të rinjtë.

Meqenëse informacioni për të rinjtë funksionon në një sërë mjedisesh, statusi dhe njohja e vlerës së punonjësve të IR ndryshojnë nga njëri shtet në tjetrin. Megjithatë, ka elemente të përsëritur në natyrën dhe funksionimin e shërbimeve, duke përfshirë:

- Bashkëpunimin ndërkombëtar, që përfshin angazhimin në rrjetet dhe projektet evropiane dhe ndërkombëtare për të mbështetur mësimin dhe bashkëpunimin reciprok;
- Komunikimin, duke përfshirë markimin, shtimin e ndërgjegjësimit dhe kontaktimin me të rinjtë dhe palët e interesuara;
- Shërbimet online si një mënyrë për të kontaktuar njerëzit dhe për të ofruar informacion;
- Performancën, duke përfshirë monitorimin e nivelit të shërbimit dhe efikasitetit;
- Modelin organizativ, duke përfshirë koordinatorët kombëtarë, rrjetet rajonale dhe palët e interesuara;
- Kompetencat e kërkuara nga punonjësit dhe ekipet e informacionit të të rinjve;
- Legjislacionin, politikat dhe rregulloret që ndikojnë në statusin dhe funksionimin e shërbimit;
- Financimin dhe menaxhimin financiar;
- Hulumtimin dhe analizat e nevojave të të rinjve, temave dhe metodave përkatëse për shërbimet e punës informative për të rinjtë;
- Rolin strukturor të shërbimeve të informacionit për të rinjtë në kontekstin e politikës kombëtare për rininë; dhe
- Identifikimin dhe bashkëpunimin me ofrues të tjerë të shërbimeve të informacionit.

⁷ Parimet janë: i pavarur, i aksesueshëm, gjithëpërfshirës, i bazuar në nevoja, fuqizues, pjesëmarrës, etik, profesional, proaktiv. Teksti i plotë i Kartës mund të gjendet në: KARTA EVROPIANE E INFORMACIONIT RINOR — ERYICA.

Statusi ligjor

Së pari, në një sërë vendesh nuk ka asnjë referencë të qartë për PIR brenda politikës rinore ose kuadrin ligjor të vendit, dhe mund të ketë mungesë të koordinimit kombëtar/rajonar të shërbimeve. Rrjedhimisht, punonjësit ose shërbimet e informacionit për të rinjtë, mund të kenë një rol minimal në qeverisjen dhe politikë bërjen e politikave rinore, gjë që mund të çojë në mungesë koherence, cilësie dhe njohjeje të PIR.

Së dyti, duke reflektuar situatën në shumicën e vendeve evropiane, PIR është një pjesë e integruar e punës rinore. Në raste të tilla, puna e informimit për të rinjtë mund të përfshihet në politikën, strategjitë përkatëse rinore apo edhe të parashikohet nga rregulloret ligjore.

Së treti, puna e informimit për të rinjtë mund të vendoset si një shtyllë e tretë e politikës rinore krahas organizatave rinore dhe punës rinore, me një rol aktiv në formimin dhe zbatimin e politikës rinore.

Qeverisja

Për shkak të staturave të ndryshme ligjore të përshkruara më sipër, në secilin vend ka qasje të ndryshme për qeverisjen dhe koordinimin. Shërbimet e informacionit për të rinjtë mund të operohen përmes një qendre të vetme kombëtare, përmes një shoqate qendrash me një organ koordinues, përmes një koordinatori/mbështetës teknik, si pjesë e një agjencie kombëtare, ose në disa raste, pa koordinim.⁸

Për më shumë informacion mbi funksionimin e PIR në Evropë, ju lutemi shikoni botimin [Youth Information and Counselling in Europe in 2020](#)⁹ 

⁸ Përmbledhje e strukturave kombëtare të informacionit dhe këshillimit rinor (fq. 74), ERYICA dhe Këshilli i Evropës, (Maj 2015)

⁹ Informacioni dhe Këshillimi Rinor në Evropë në 2020 (f.9). ERYICA (dhjetor 2020). Botuar sipas Marrëveshjes së Partneritetit ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Agjencisë Evropiane të Informacionit dhe Këshillimit për Rininë (ERYICA).

PJESA 2

Korniza e Kompetencës

së Punonjësve të Informacionit të Rinisë



2.1 Tablo e përgjithshme

Korniza e Kompetencave të Punonjësve të Informacionit Rinor (YouthInfoComp) është një kornizë fleksibël referimi për të mbështetur zhvillimin dhe kuptimin e kompetencave të punonjësve të informacionit për të rinjtë (punonjës IR) në çdo mjedis.

YouthInfoComp nuk synohet si një përshkrim urdhërues ose një standard profesional që duhet të zbatohet në një mënyrë specifike. Korniza në fjalë, përshkruan grupin minimal të kompetencave që kërkohen për punonjësit e IR për të përmbushur detyrat e tyre në mënyrë profesionale. Është ndërtuar dhe hartuar në mënyrë të tillë që të mund të përshtatet dhe zbatohet në sisteme të ndryshme.

Korniza përbëhet nga katër pjesë:

1. **PËRKUFIZIMI:** një përkufizim të dakorduar të profilit të punonjësit të IR, i cili mbështet zhvillimin e kornizës së kompetencave.




Kuadri i referohet vetëm “punonjësve të informacionit për të rinjtë” dhe “shërbimeve të informacionit për të rinjtë”, por është e rëndësishme të kihet parasysh se **shërbimet e ofruara mund të vendosen në kontekste të ndryshme dhe të ofrohen nga shumë aktorë të ndryshëm me tituj të ndryshëm në mjedise dhe vende të ndryshme (shih *Puna Informative Rinore në Evropë* në Pjesën 1). Po kështu, termi “**punë informative për të rinjtë**” përdoret në të gjithë kornizën, por ky term përfshin një gamë të gjerë shërbimesh dhe veprimtarish, të tilla si informimi, *këshillimi*, *mentorimi*, *mbështetja*, *udhëzimi*, *trajnimi* ose referimi në shërbime të specializuara dhe veprimtari mes bashkëmoshatarësh, rrjetëzimi dhe angazhimi i palëve të interesuara.**

2. **FUSHAT E KOMPETENCAVE:** tre kategori të nivelit të lartë për të përshkruar kompetencat e punonjësve të IR dhe për t'i dhënë strukturë kornizës së kompetencave.
3. **TITUJT DHE PËRSHKRUESIT E KOMPETENCAVE:** 12 kompetencat individuale që, së bashku, përfaqësojnë kompetencat thelbësore të kërkuara për punonjësit e IR për të kryer detyrat e tyre në mënyrë profesionale.
4. **REZULTATET E TË NXËNIT:** deklaratat e rezultateve të të nxënit për të shtjelluar çdo kompetencë në aspektin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve.

Korniza e kompetencave është hartuar në anglisht. Organizatat dhe shërbimet kombëtare mund ta përkthejnë kornizën e kompetencave dhe këtë botim, megjithatë rekomandohet që çdo nismë përkthimi, të koordinohet me partnerë të tjerë kombëtarë dhe me partnerë në vende të tjera që punojnë në të njëjtën gjuhë, për të shmangur krijimin e versioneve të shumta të së njëjtit versioni gjuhësor.

2.2 Fushat e kompetencave

YouthInfoComp përbëhet nga tre fusha të gjera (A1 – A3 në tabelën më poshtë) të titulluara «Mbështetja dhe Angazhimi i të Rinjve», «Shërbimi cilësor» dhe «Komunikimi dhe Shtrirja».

	A1	MBËSHTETJA dhe ANGAZHIMI I TË RINJVE mbulon kompetencat që lidhen me ndërveprimin me të rinjtë, përfituesit përfundimtarë të punës së punonjësve të informacionit për të rinjtë.
	A2	SHËRBIM CILËSOR mbulon kompetencat që lidhen me aspektet operacionale të ofrimit të shërbimeve të informacionit për të rinjtë në një mënyrë profesionale, etike dhe gjithëpërfshirëse.
	A3	KOMUNIKIMI dhe KONTAKTIMI mbulon kompetencat që lidhen me ndërtimin e marrëdhënieve dhe përdorimin e mjeteve dhe kanaleve për të rritur ndikimin dhe shtrirjen e shërbimeve të informacionit për të rinjtë.


Fushat në fjalë, i japin strukturë kornizës së kompetencave dhe përcaktojnë temat për kompetencat e përfshira. Zonat mund t'i shërbejnë një funksioni të rëndësishëm në përdorimin e kornizës, duke ofruar zona të nivelit të lartë për planifikim strategjik, prioritete dhe veprim.

2.3 Kompetenca

YouthInfoComp përbëhet nga 12 kompetenca (C1 – C12 në tabelën e mëposhtme) grupuar në tre fusha kyçe: «Mbështetja dhe Angazhimi i të Rinjve», «Shërbimi cilësor» dhe «Komunikimi dhe Shtrirja» e përshkruar më sipër.

Çdo kompetencë ka një titull dhe përshkrim specifik që shpjegon vlerën dhe zbatimin e kësaj kompetence për PIR.

Nuk ka hierarki brenda kornizës; të gjitha kompetencat e përshkruara janë të së njëjtës rëndësi.





MBËSHTETJA dhe ANGAZHIMI I TË RINJVE

	KOMPETENCË	PËRSHKRIM
C1	Akumulimi i njohurive	Ndërtoni dhe përditësoni njohuritë mbi tema të ndryshme që lidhen me të rinjtë.
C2	Identifikimi i nevojave	Dëgjojeni në mënyrë aktive dhe angazhohuni me të rinjtë për t'i aftësuar ata të identifikojnë dhe shprehin nevojat e tyre.
C3	Menaxhimi i informacionit	Kërkoni, vlerësoni dhe menaxhoni të dhëna nga burime të ndryshme, të besueshme për të ofruar informacion të përshtatshëm, gjithëpërfshirës dhe të verifikueshëm për të rinjtë.
C4	Krijimi i opinioneve	Përshtatni informacionin dhe ndihmoni të rinjtë të identifikojnë opsionet që mund t'i fuqizojnë ata, të nxisin autonominë e tyre dhe të mbështesin qytetarinë dhe pjesëmarrjen aktive.



SHËRBIM CILËSOR

	KOMPETENCË	PËRSHKRIM
C5	Ruajtja e moralit dhe vlerave	Ofroni shërbime cilësore të informacionit për të rinjtë që mbështesin të drejtën e të rinjve për informacion të plotë dhe të besueshëm, që i ndihmojnë ata të marrin vendime dhe zgjedhje efektive për sfidat me të cilat përballen në jetën e tyre dhe që promovojnë autonominë e tyre, aftësinë për të menduar në mënyrë kritike dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri.
C6	Përmirësimi i mësimin dhe zhvillimit	Siguroni zhvillimin e vazhdueshëm vetjak dhe profesional të punonjësve, ekipeve dhe organizatave individuale të informacionit për të rinjtë, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara.
C7	Mbështetja e përfshirjes	Demonstroni ndërgjegjësimin dhe shprehjen kulturore, sjelljen etike dhe mbështetni përfshirjen dhe aksesin në mënyrë që puna e informimit të të rinjve të mos diskriminojë mbi asnjë bazë.
C8	Respektimi i privatësisë	Respektoni dhe përmirësoni të drejtën e të rinjve për privatësi, konfidencialitet dhe anonimitet.



AFRIMI dhe KOMUNIKIMI

KOMPETENCË		PËRSHKRIM
C9	Ndërtimi i marrëdhënieve	Ofroni mbështetje dhe informacion në një mënyrë të personalizuar dhe angazhuese, për të siguruar që i riu të ndihet i fuqizuar, i dëgjuar dhe i sigurt.
C10	Komunikimi në mënyrë efektive	Përdorni mënyra plot risi, efektive dhe të përshtatshme komunikimi për të hartuar dhe shpërndarë informacion të përshtatur për të rinjtë.
C11	Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi	Identifikoni dhe zhvilloni në mënyrë proaktive mundësitë e avokimit, rrjetëzimit dhe bashkëpunimit me shërbimet dhe palët e tjera përkatëse.
C12	Kontaktimi	Zbatoni strategji efektive dhe me risi të informimit, për shërbimet e informacionit për të rinjtë, me qëllim arritjen sa më shumë të rinj që të jetë e mundur.

2.4 Rezultatet e të mësuarit

Çdo kompetencë shtjellohet më tej si rezultate mësimore (shih Shtojcën I). Rezultatet e të nxënit janë deklaratat e asaj që një person di, kupton dhe është në gjendje të bëjë pas përfundimit të të nxënit (Cedefop, 2009). Për qëllimet e YouthInfoComp, rezultatet e të nxënit të përfshira, shprehen në terma të njohurive (Unë e kuptoj...), aftësive (Unë mundem...) dhe qëndrimeve (Unë ndjej...).

- Çdo element i njohurive është një temë specifike (koncepte, fakte dhe shifra, ide dhe teori, fusha politikash) të cilat punonjësit e IR duhet të jenë në gjendje t'i kuptojnë, t'ua shpjegojnë të tjerëve dhe t'i zbatojnë në mënyrë efektive në punën e tyre.
- Çdo element aftësie është një veprim ose aftësi specifike për të kryer procese të cilat punonjësit e IR duhet të jenë në gjendje të demonstronjë në punën e tyre.
- Secili qëndrim është një emocion specifik ose mendësi që tregon se si punonjësit e IR duhet të reagojnë ndaj njerëzve, ideve ose situatave në punën e tyre.

Rezultatet e të nxënit janë formuluar si deklaratat me «Unë ...», pasi ato i referohen më së shumti kapacitetit të individëve (d.m.th. «Unë e kuptoj ...», «Unë mund ...», «Unë ndjej ...»). Kjo është për të inkurajuar një ndjenjë pronësie dhe për të demonstruar rëndësinë për punonjësin individual të informacionit për të rinjtë. Sidoqoftë, kompetencat trajtojnë gjithashtu rëndësinë e punës me grupe, ekipe dhe bashkëmoshatarë, ndërkohë që korniza mund të zbatohet për grupet e punonjësve të të rinjve të informacionit, ekipet e projektit, situatat e të punuarit së bashku, dhe në institucione të tëra sipas nevojës.

Rezultatet e të nxënit për secilën kompetencë **janë gjithëpërfshirëse**, duke mbuluar funksionet thelbësore të PIR, por ato **nuk synohen të paraqiten si një listë shteruese e deklaratave fikse të parapërcaktuara**. PIR kërkon rritje, inovacion dhe identifikim të zgjidhjeve, kështu që punonjësve të IR në shumë raste do t'u duhet të zhvillojnë kompetenca shtesë, të përparojnë dhe të bëhen më të specializuar në fusha të veçanta, në varësi të nevojave të përdoruesve të tyre. Rezultatet e të nxënit që përfshihen, përshkruajnë grupin minimal të kompetencave të kërkuara për punonjësit e IR dhe **mund të shtohen, përshtaten dhe përdoren si bazë për zhvillimin e rezultateve specifike të të nxënit** që pasqyrojnë realitetet kombëtare të shërbimeve dhe punonjësve të IR.

Rezultatet e të nxënit përfshijnë si kompetenca «transversale» të lidhura me profesionalizmin, aftësitë ndërpersonale dhe bashkëpunimin, si dhe kompetencat që janë specifike për profilin e YIW, si aftësia për t'u empatizuar me të rinjtë dhe njohuritë e politikave që lidhen me të rinjtë. YouthInfoComp ofron një pikënisje të përbashkët për të kuptuar dhe zhvilluar profilin e punonjësit IR, por duhet të përdoret në kombinim me mjete të tjera për ta zgjeruar dhe përshtatur plotësisht atë.

Nivelet e progresit

Kornizat e kompetencave, në disa raste, mund të përdoren për të hartuar progresin në zhvillimin e kompetencave, p.sh., përparimin në aftësi në gjuhë të ndryshme ose në zhvillimin e aftësive dixhitale. Nivelet e progresit mund të ndihmojnë në vlerësimin e pikave të ndryshme fillestare, për të vlerësuar të nxënit me kalimin e kohës ose për të hartuar një rrugë mësimi për të zhvilluar kompetenca të reja.

Nivelet e detajuara, të përshtatura të përparimit, nuk janë përfshirë në dizajnin e *YouthInfoComp*. Modele të tilla të detajuara ose të grimcuara të progresionit nuk mund të zbatohen realisht në kornizë në një mënyrë të përdorshme pasi natyra e profilit të punonjësve të IR dhe organizimi i shërbimeve ndryshon kaq shumë nga njëri shtet në tjetrin dhe po ashtu edhe nga njëri sistem në tjetrin.

Nivelet e gjera të përparimit të «Themelimit», «Operacionalitetit», «Fuqizimit të të tjerëve» dhe «Transformimit» mund të zbatohen gjithsesi si tregues të progresit në zhvillimin e kompetencave.

- **Themelimi:** i rëndësishëm për hyrjet e reja, të trajnuarit ose punonjësit që ende nuk mund të demonstrojnë kompetencat kryesore.
- **Operacionalizimi:** me lidhje për punonjësit që janë themeluar në rolin e tyre si punonjës të IR, ata mund të demonstrojnë kompetenca kyçe dhe të angazhohen në zhvillimin e vazhdueshëm profesional.
- **Fuqizimi i të tjerëve:** i rëndësishëm për punonjësit që operojnë në role udhëheqëse, mentoruese ose trajnuese, që mund të mbështesin të tjerët dhe të organizojnë punën.
- **Transformimi:** e rëndësishme për punonjësit të cilët kanë kapacitetin për të identifikuar dhe zbatuar ndryshimin ose transformimin në shërbimin përkatës, si dhe që mund të veprojnë në role menaxheriale dhe strategjike.

Këto nivele të progresionit duhet të përdoren vetëm si tregues; ato mund të përdoren nga punonjës individualë për të identifikuar qëllimet e zhvillimit dhe nga punëdhënësit dhe menaxherët si bazë për të zhvilluar tregues më të përshtatshëm të progresionit, nëse është e nevojshme.

2.5 Përdorimi i kuadrit

Punonjësit e informacionit për të rinjtë mund të përdorin YouthInfoComp për të:

- Kuptuar rolin dhe detyrat e tyre si punonjës të IR;
- Shpjegojnë dhe komunikojnë rolin e tyre ndaj të rinjve dhe palëve të interesuara;
- Identifikojë fushat për përmirësim në angazhimin dhe ndërveprimin me të rinjtë dhe palët e interesuara;
- Identifikojë fushat për përmirësim në funksionimin e shërbimeve;
- Përcaktojnë objektivat e zhvillimit profesional dhe përgatitë për rishikimin e performancës;
- Identifikojë boshllëqet e aftësive dhe vendosë synime mësimore; dhe
- Identifikojë mundësitë përkatëse për arsimim dhe trajnim.

Organizatrat që ofrojnë shërbime informacioni për të rinjtë, mund të përdorin YouthInfoComp për të:

- Promovuar të kuptuarit, dukshmërinë dhe njohjen e profilit dhe shërbimeve të PIR;
- Krijuar vende të lira të punës, kriteret e rekrutimit dhe planet e zhvillimit të Burimeve Njerëzore në sektorin e punës së IR;
- Rritja e rolit të shërbimeve PIR në hartimin dhe zhvillimin e shërbimeve dhe politikave rinore në nivel vendor, rajonal, kombëtar dhe në atë evropian;
- Ndjekja e njohjes së profilit të PIR në nivel evropian, kombëtar, rajonal ose vendor;
- Komunikimi i vlerës së PIR me të rinjtë dhe palët e interesuara; dhe
- Identifikimi i nevojave për zhvillimin e aftësive dhe mundësitë e edukimit dhe trajnimit për punonjësit e IR.



Shtojca 1

Rezultatet e të mësuarit



A1. MBËSHTETJA dhe ANGAZHIMI I TË RINJVE



Punonjësit e informacionit për të rinjtë ofrojnë informacion dhe mundësi të personalizuar të synuara për të mbështetur dhe angazhuar të rinjtë bazuar në nevojat e tyre. Këto kompetenca fokusohen në zhvillimin e njohurive, përfshirjen dhe ndërveprimin me të rinjtë, përfituesit përfundimtarë të punës së informacionit për të rinjtë.

Rezultatet e të nxënit shprehen në terma të njohurive (Unë e kuptoj...), aftësive (unë mundem...) dhe qëndrimit (unë ndjehem ...).

C1 Ndërtoni njohuri

Ndërtoni dhe përditësoni njohuritë mbi tema të ndryshme që lidhen me të rinjtë.

Unë kuptoj...

- » Shumëllojshmërinë dhe thellësinë e temave që mund të ndikojnë në jetën e të rinjve.
- » Rolin e njohurive dhe bashkëpunimit në zhvillimin e informacionit të përshtatshëm, gjithëpërfshirës, të verifikueshëm, opsioneve dhe fushave për përmirësim për të mbështetur të rinjtë.
- » Rëndësinë e ndërtimit të vazhdueshëm për të kuptuar dhe mbështetur nevojat e tyre.

Unë mundem...

- » Të ndërtoj dhe zbatoj njohuri të specializuara për tema të rëndësishme për të rinjtë, aty ku është e nevojshme.
- » Të ndërtoj dhe aplikoj njohuri të reja mbi menaxhimin e karrierës, punësueshmërinë dhe mësimin gjatë gjithë jetës, që janë të rëndësishme për të rinjtë.
- » Të ndërtoj dhe aplikoj njohuri të reja për kohën e lirë, hobit, udhëtimet dhe lëvizshmërinë.
- » Të ndërtoj dhe aplikoj njohuri të reja mbi shëndetin, mirëqenien, strehimin, aksesin në të drejta, të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen qytetare dhe sociale të rëndësishme për të rinjtë.

Unë ndjehem...

- » I motivuar për të ndërtuar, aplikuar, ndarë dhe përditësuar njohuritë mbi të gjitha temat që lidhen me të rinjtë.

<p>C2 Identifiko nevojat</p>	<p>Dëgjojini në mënyrë aktive dhe angazhohuni me të rinjtë për t'i mundësuar ata të identifikojnë dhe shprehin nevojat e tyre.</p>
<p>Unë kuptoj...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Sfondin social-kulturor-ekonomik të të rinjve në kontekstin vendor. » Se çdo i ri është unik dhe mund të përballet me situata dhe sfida të ndryshme në jetën e tij personale. » Tendencat, legjislacionin dhe kontekstet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare që prekin të rinjtë.
<p>Unë mundem...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Të bëj pyetjet e duhura dhe të synuara për të mbledhur informacion përkatës nga të rinjtë për të identifikuar nevojat e tyre themelore. » Të dëgjoj në mënyrë aktive për të angazhuar të riun pa e ndërprerë apo bërë gjykime. » Të monitoroj gjuhën e trupit për të kuptuar nevojat e të rinjve dhe për të zbuluar çështjet që duhen adresuar.
<p>Unë ndjehem...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Në gatishmëri për të mësuar rreth prejardhjes/kontekstit/realitetit të të rinjve.
<p>C3 Manaxho Informacionin</p>	<p>Kërkoni, vlerësoni dhe menaxhoni të dhëna nga burime të ndryshme, të besueshme për të ofruar informacion të përshtatshëm, gjithëpërfshirës dhe të verifikueshëm për të rinjtë.</p>
<p>Unë kuptoj...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Përdorimin e strategjive të kërkimit për të identifikuar burimet përkatëse të informacionit online dhe offline. » Proceset për identifikimin e informacionit të saktë, të plotë, të përditësuar dhe të verifikuar. » Teknikat për menaxhimin e mbingarkesës së informacionit dhe njohjen e dezinformatave.
<p>Unë mundem...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Të krijoj dhe zhvilloj një depo të burimeve të informacionit gjithëpërfshirës, të pavarur dhe të verifikueshëm, që lidhet me të rinjtë. » Të kërkoj, qasem, vlerësoj në mënyrë kritike, si dhe të ruaj informacionin përkatës nga burime online dhe offline. » T'u mundësoj të rinjve që të përdorin shërbimet dixhitale të synuara për ta për të aksesuar informacionin dhe mbështetjen përkatëse.
<p>Unë ndjehem...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » I/e motivuar për të reflektuar në mënyrë aktive dhe të përditësuar proceset e menaxhimit të informacionit për të siguruar cilësinë dhe rëndësinë e informacionit të dhënë.

C4 Krijo opsione

Përshtatni informacionin dhe ndihmoni të rinjtë të identifikojnë opsionet që mund t'i fuqizojnë ata, të nxisin autonominë e tyre dhe të mbështesin qytetarinë dhe pjesëmarrjen aktive.

Unë kuptoj...

- » Si të vlerësoj dhe punoj me informacionin, si dhe se si të krijoni opsione në një kontekst specifik.
- » Si të krijoj opsione që parashikojnë nevojat e ardhshme dhe të marr masa parandaluese në përputhje me rrethanat.
- » Kur duhet t'i referoj të rinjtë tek shërbime ose burime të tjera të përshtatshme për t'u marrë me çështje komplekse, duke përfshirë këtu rastet kur janë të nevojshme këshilla, veprime ligjore ose të tjera prej specialistësh.

Unë mundem...

- » Ta përshtat informacionin kompleks ose të përgjithshëm, në opsione të personalizuar e të synuara që janë të lehta për t'u kuptuar dhe të orientuara ndaj nevojave të të rinjve.
- » Të mbështes të riun që të zbatojë aftësitë e shkrim-leximit për informacionin mediatik, për të vlerësuar në mënyrë kritike informacionin dhe për të dalluar faktet nga opinionet dhe dezinformatat.
- » Bashkëpunoni dhe mbështesni të riun që të zgjedhë midis opsioneve dhe të marrë vendime, pa i drejtuar ata.

Unë ndjehem...

- » I gatshëm për të hulumtuar dhe për të qëndruar të përditësuar me çështjet me të cilat përballen të rinjtë për të gjetur zgjidhje më të mira për problemet e reja dhe ekzistuese.
- » I përkushtuar për të përfshirë të rinjtë në procesin e hartimit dhe shpërndarjes së informacionit për të rinjtë.

A2. SHËRBIM CILËSOR



Punonjësit e informacionit për të rinjtë ofrojnë një shërbim cilësor për të rinjtë, pa pagesë, shërbim i cili respekton diversitetin, etikën dhe privatësinë, si dhe mbështetet nga një kulturë e përmirësimit të vazhdueshëm. Këto kompetenca fokusohen në aspektet operationale të ofrimit të shërbimeve të IR në një mënyrë profesionale, etike dhe gjithëpërfshirëse.

Rezultatet e të nxënit shprehen në terma të njohurive (Unë e kuptoj...), aftësive (Unë mund...) dhe qëndrimit (Unë ndjehem ...).

C5 Ruajtja e moralit dhe vlerave

Ofroni shërbime cilësore të informacionit për të rinjtë që mbështesin të drejtën e të rinjve për informacion të plotë dhe të besueshëm, i cili i ndihmon ata të marrin vendime dhe zgjedhje efektive për sfidat me të cilat përballen në jetën e tyre dhe që promovon autonominë e tyre, aftësinë për të menduar në mënyrë kritike dhe pjesëmarrjen aktive në shoqëri.

Unë kuptoj...

- » Objektivat, misioni dhe vlerat e punës së informacionit për të rinjtë, duke përfshirë Parimet e Kartës Evropiane të Informacionit për Rininë dhe Parimet e Eurodesk-ut, dhe mënyrën se si ato zbatohen në kontekstet vendore, rajonale, kombëtare ose ndërkombëtare.
- » Si të përcaktoj objektivat personale, ekipore dhe organizative bazuar në vlerësimin e nevojave dhe se si të krijohet një proces për të monitoruar arritjen e objektivave.
- » Strukturat evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe kontekstin e punës së informacionit për të rinjtë, duke përfshirë rrjetet, politikat dhe projektet e bashkëpunimit evropian.

Unë mundem...

- » Të identifikoj se si zhvillimet e politikave lidhen me punën e informacionit për të rinjtë dhe ti maksimalizoj ato për të promovuar të kuptuarit dhe vlerën e punës së informacionit për të rinjtë
- » Të përcaktoj dhe zbatoj objektivat personale, ekipore dhe organizative që mbështesin misionin dhe vlerat e punës së informacionit të të rinjve në hartimin dhe mirëmbajtjen e burimeve dhe ofrimin e shërbimeve.
- » Të krijoj dhe të marr pjesë në procese për të monitoruar dhe vlerësuar në mënyrë kritike arritjen e objektivave organizative dhe personale.
- » Të zbatoj metodologjitë e zhvillimit të qëndrueshëm në praktikën e përditshme/dhënien e informacionit për të rinjtë.

Unë ndjehem...

- » I angazhuar për të promovuar dhe mbështetur moralin dhe vlerat e punës së informacionit rinor në ofrimin e shërbimeve.

C6 Përmirësoni mësimin dhe zhvillimin

Siguroni zhvillimin e vazhdueshëm personal dhe profesional të punonjësve, ekipeve dhe organizatave individuale të informacionit për të rinjtë, me qëllim për të rritur cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Unë kuptoj...

- » Si të reflektosh, monitorosh dhe rishikosh zhvillimin e kompetencave të punonjësit të informacionit për të rinjtë.
- » Si të inkurajosh reagimet pozitive dhe negative nga të rinjtë, si dhe të identifikosh fushat për përmirësim për veten dhe/ose ekipin tim.

Unë mundem...

- » Të identifikosh fushat për përmirësim ose inovacion në ofrimin e shërbimeve nga unë ose ekipi im, bazuar në tendencat aktuale të të dhënave dhe reagimet nga përvojat, interesat dhe nevojat e të rinjve.
- » Të zhvillosh dhe të ndaj njohuritë, burimet dhe praktikën më të mira me pjesëtarët e ekipit dhe kolegët.
- » Të caktoj qëllime mësimore si dhe të organizosh veprimtari mësimore, me mbështetje aty ku është e nevojshme, për të siguruar zhvillim të vazhdueshëm profesional.

Unë ndjehem...

- » I motivuar për të mësuar dhe për të krijuar një kulturë të të mësuarit dhe përmirësimit të vazhdueshëm brenda ekipit tim.

C7 Mbështet përfshirjen

Demonstroni ndërgjegjësimin dhe shprehjen kulturore, sjelljen etike dhe mbështesni përfshirjen dhe aksesin në mënyrë që puna e informacionit për të rinjtë të mos diskriminojë mbi asnjë motiv.

Unë kuptoj...

- » Konceptet, metodat dhe politikat aktuale mbi identitetin, kulturën dhe sfondin.
- » Konceptet, metodat dhe politikat aktuale mbi orientimin seksual, identitetin gjinor dhe shprehjen gjinore.
- » Konceptet, metodat dhe politikat aktuale mbi etikën duke përfshirë barazinë, drejtësinë, përfshirjen dhe qëndrueshmërinë mjedisore.
- » Konceptet, metodat dhe politikat aktuale për aksesin dhe mbështetjen për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe nevoja të veçanta.

Unë mundem...

- » Të sigurosh informacione dhe opsione pa paragjykime pa ndonjë ndikim fetar, politik, ideologjik ose tregtar.
- » Të demonstroj sjellje etike dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha ndërveprimet me të rinjtë dhe të promovoj sjelljen dhe politikat etike brenda institucionit tim dhe midis pjesëtarëve të ekipit të punës.
- » Të hulumtoj dhe të jap informacion dhe opsione që mund të përmirësojnë kushtet e individëve ose grupeve të cënueshme.

Unë ndjehem...

- » Përgjegjës për të qenë gjithëpërfshirës, tolerant dhe i hapur ndaj dallimeve mes vetes time dhe të tjerëve.

**C8 Respektoni
privatësinë****Respektoni dhe përmirësoni të drejtën e të rinjve për
privatësi, konfidencialitet dhe anonimitet.****Unë kuptoj...**

- » Rëndësinë e konfidencialitetit dhe anonimitetit gjatë punës me të rinjtë.
- » Kërkesat për privatësinë e të dhënave, duke përfshirë «deklaratën e privatësisë» organizative dhe proceset për mbledhjen dhe ndarjen e çdo të dhëne personale.
- » Si të veprojmë dhe të kërkojmë këshilla në rastet e ndonjë shkeljeje të kërkesave të të dhënave.

Unë mundem...

- » Të përdor sisteme organizative për të mbrojtur pajisjet dixhitale/online dhe çdo dokument fizik që përmban informacion personal.
- » Të informoj të rinjtë për mbrojtjen e privatësisë, konfidencialitetit dhe anonimitetit të tyre.
- » Të informoj pjesëtarët e ekipit të punës, dhe kolegët, se si zbatohen kërkesat e privatësisë organizative, konfidencialitetit dhe anonimitetit për punën e informacionit për të rinjtë.

Unë ndjehem...

- » Respektues i të drejtës së të rinjve për privatësi, konfidencialitet dhe anonimitet.

A3. AFRIMI dhe KOMUNIKIMI



Punonjësit e informacionit të të rinjve, zbatojnë aktivitete efektive komunikimi për të ndërtuar marrëdhënie me të rinjtë dhe për të maksimizuar ndikimin dhe shtrirjen e shërbimeve të tyre. Këto kompetenca përqendrohen në ndërveprimin personal si dhe në përdorimin e mjeteve dhe kanaleve multimediale për të rritur ndikimin dhe shtrirjen e shërbimeve të informacionit për të rinjtë.

Rezultatet e të nxënit shprehen në terma të njohurive (Unë kuptoj...), aftësive (Unë mundem...) dhe qëndrimit (Unë ndjehem...).

C9 Ndërtoni marrëdhënie

Ofroni mbështetje dhe informacion në një mënyrë të këndshme, tërheqëse për të siguruar që i riu të ndihet i fuqizuar, i dëgjuar dhe i sigurt.

Unë kuptoj...

- » Teknika për ndërveprim dhe dialog mbështetës dhe fuqizues me të rinj dhe grupe individuale.
- » Rolin e ndjeshmërisë dhe vetë-ndjeshmërisë në të kuptuarit e emocioneve, përvojave dhe pikëpamjes së një personi tjetër.
- » Rolin e vetërregullimit, duke përfshirë vetëdijen, përgjigjet rregulluese dhe qëllimin, në ndërtimin e marrëdhënieve pozitive.

Unë mundem...

- » Të dizenjoj dhe lehtësoj një mjedis mikpritës, miqësor ndaj të rinjve dhe të sigurt.
- » Zhvilloj dhe mbaj një raport pozitiv me çdo të ri.
- » Rregulloj stilin e komunikimit dhe gjuhën e trupit për të ndërvepruar me sukses me çdo të ri.
- » Të menaxhoj çdo situatë konflikti në mënyrë të respektueshme dhe të gjej kompromise që adresojnë nevojat e të gjitha palëve.

Unë ndjehem...

- » I përkushtuar për të ndërtuar një marrëdhënie pozitive me çdo të ri në një mjedis të sigurt ku ndjenjat dhe emocionet mund të shprehen lirshëm dhe me respekt.

<p>C10 Komunikohet me efektivitet</p>	<p>Përdorni mënyra inovative, efektive dhe të përshtatshme të komunikimit për të hartuar dhe ofruar informacion tërheqës, të përshtatur për të rinjtë.</p>
<p>Unë kuptoj...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Njohuritë mediatike dhe informative për hartimin dhe shpërndarjen e informacionit dhe komunikimit të përshtatshëm e tërheqës që synon të rinjtë. » Rregullat e krijimit të përmbajtjes duke përfshirë të drejtën e autorit dhe licencimin. » Netiketën (sjellje e pranueshme në internet) dhe si të mbron informacionin personal në internet.
<p>Unë mundem...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Të hartoj dhe zbatoj aktivitete komunikimi, faqe interneti dhe publikime në përputhje me objektivat dhe prioritetet organizative. » Të shkruaj përmbajtje koncize të qartë, të synuar dhe jepni informacion verbalisht (duke përfshirë në gjuhë të huaja, ku është e mundur) për grupe të ndryshme të rinjsh. » Bashkë-dizenjoj dhe shpërndaj materiale komunikimi në partneritet me të rinjtë.
<p>Unë ndjehem...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » I motivuar për të komunikuar dhe shpërndarë informacion tek të rinjtë në një mënyrë tërheqëse dhe fuqizuese.
<p>C11 Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi</p>	<p>Identifikoj dhe zhvilloj në mënyrë proaktive mundësitë e avokimit, rrjetëzimit dhe bashkëpunimit me shërbimet dhe palët e tjera përkatëse.</p>
<p>Unë kuptoj...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Nevojën për bashkëpunim dhe ndarje të burimeve ndërmjet shërbimeve për mbështetjen e të rinjve. » Gamën e palëve të interesit, aktorëve dhe sistemeve në nivel vendor, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar që punojnë në interes të të rinjve. » Potencialin për sinergji dhe bashkëpunim midis shërbimeve të informacionit për të rinjtë dhe shërbimeve të tjera që funksionojnë në interes të të rinjve në nivel vendor, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.
<p>Unë mundem...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Të identifikoj mundësitë e bashkëpunimit dhe avokimit, filloj kontaktet dhe zhvilloj dhe mbaj marrëdhënie strategjike pune me shërbimet, organizatat dhe palët e interesuara përkatëse. » Zhvilloj mesazhe dhe shkruaj përmbajtje të qartë koncize për grupet e palëve të interesuara (në gjuhë të huaja, ku është e mundur). » Aty ku është e përshtatshme, përfaqësoj organizatën time dhe profilin dhe interesat e punës së informacionit për të rinjtë, duke përfshirë të folurit publik, projektet dhe rrjetëzimin.
<p>Unë ndjehem...</p>	<ul style="list-style-type: none"> » Si person që e vlerëson, vlerën e shtuar të partneritetit të ri dhe mundësive të bashkëpunimit dhe i motivuar për të marrë përsipër përgjegjësi përfaqësuese dhe rrjetëzimin.

C12 Kontaktimi**Zbatoni strategji efektive dhe me risi për shërbimet e informacionit për të rinjtë, me qëllim për të arritur sa më shumë të rinj që të jetë e mundur.****Unë kuptoj...**


- » Si të përdoren kanalet e komunikimit, përfshirja e palëve të interesuara (përfshirë të rinjtë) dhe shumëfishuesit (përfshirë ambasadorët) për të maksimizuar shtrirjen dhe ndërgjegjësimin për shërbimet e informacionit për të rinjtë.
- » Si të zhvillohet dhe mirëmbahet baza e të dhënave e palëve të interesuara dhe si të menaxhohet angazhimi i palëve të interesuara.
- » Si të përcaktohen objektivat e shtrirjes, të monitorohet ndikimi dhe të veprohet mbi rezultatet për të përmirësuar shtrirjen.

Unë mundem...

- » Të hartoj dhe të zbatoj aktivitete të komunikimit në përputhje me objektivat dhe prioritetet organizative.
- » Të komunikoj qartë qëllimin dhe vlerën e shtuar të shërbimeve të informacionit për të rinjtë tek grupet më të gjera të synuara.
- » Hartoj rregullisht hapësirat dhe mjediset e kontaktit me të rinjtë. Identifikoj dhe lidhem me fushata të tjera përkatëse të komunikimit dhe tendencat në internet për të maksimizuar dukshmërinë dhe ndikimin.

Unë ndjehem...

- » I përkushtuar për të siguruar që shërbimet e informacionit për të rinjtë të jenë të aksesueshme, të dukshme dhe tërheqëse për sa më shumë të rinj që të jetë e mundur, veçanërisht për të rinjtë e cenueshëm dhe ata me më pak mundësi.





European youth information
and counselling agency

eurodesk



eryica.org
eurodesk.eu

ISBN 978-2-919810-40-6



9 782919 810406